



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

# RAPORT

## PËR FINANCAT VENDORE

6 - mujori  
JANAR – QERSHOR 2022





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE  
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

# RAPORT PËR FINANCAT VENDORE

*6 - mujori  
JANAR – QERSHOR 2022*

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

**FINANCATLOKALE** | Forcimi i Menaxhimit  
**LOCALFINANCES** | të Financave Publike  
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO**

# Përmbajtja

Përmbledhje e gjetjeve kryesore.....	7
Statusi Fiskal i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në fund të muajit Qershor 2021 .....	10
Të dhëna për të Ardhurat Vendore .....	12
Të dhëna për Shpenzimet Vendore .....	15
Paraqitja grafike e treguesve në nivel bashkie .....	19



# **Përmbledhje e gjetjeve kryesore**


Raporti i konsoliduar për performancën e Financave Vendore gjatë periudhës 6-mujore (Janar-Qershor 2022) është përgatitur nga Drejtoria e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e ekipit të projektit “Financat Lokale”<sup>1</sup>, mbi bazën e të dhënave të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ). Në raport jepet ecuria e mbledhjes së të ardhurave vendore dhe kryerja e shpenzimeve të njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Konsolidimi financiar i pushtetit vendor gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022 reflektohet në rritjen e kapaciteteve fiskale nga të ardhurat e veta vendore, por gjithashtu dhe menaxhimi financiar në nivel vendor përmes rritjes së shpenzimeve vendore në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Të ardhurat e veta të pushtetit vendor përbëjnë 6% të totalit të të ardhurave publike në 6 mujorin e parë të vitit 2022 me një realizim prej 16.8 miliard lekë,** nga të cilat rreth 3.6 miliard lekë ose 21.7% janë arkëtuar nga taksa e pasurisë, 40 milion lekë ose 02% nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe pjesa kryesore prej 13.1 miliard lekë ose 78.1% janë arkëtuar nga grupi i taksave të tjera lokale (përfshirë tarifatat) të pushtetit vendor. Të ardhurat vendore paraqiten me performancë në rritje mjaft pozitive krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke rezultuar me një rritje prej rreth **2.9 miliard lekë më shumë ose respektivisht në masën 20%.**

**Shpenzimet e pushtetit vendor** gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022 janë rreth **24.7 miliard lekë** ose rreth 41% të planit vjetor të miratuar, duke **zënë rreth 9.4% të totalit të shpenzimeve publike të qeverisjes së përgjithshme.** Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur vetëm me rreth **2.2%.**

**Grafiku 1 paraqet ecurinë e taksave të arkëtuara nga NJVQV-të dhe shpenzimeve vendore në raport me planin vjetor.**



1. Projekti “Financat Lokale” financohet nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO




Përmirësimi i treguesve fiskalë të pushtetit vendor gjatë 6 mujorit 2022 në drejtim të konsolidimit të burimeve të të ardhurave të veta vendore ka sjellë qëndrueshmëri të menaxhimit financiar publik në nivel vendor. Burimet kryesore të të ardhurave të veta gjatë kësaj periudhe kanë pësuar një rritje të konsiderueshme duke u bërë thelbësorë për financimin e shërbimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Duke marrë në analizë strukturën e burimeve të të ardhurave të veta vendore gjatë vitit 2022, nuk konstatohen ndryshime thelbësore krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, duke ruajtur në këtë mënyrë peshën e burimeve të veta vendore.

Pavarësisht rritjes së buxhetit vendor në tërësi gjatë 6 mujorit të vitit 2022, pesha e financimit të funksioneve nga pushteti vendor nuk kanë ndryshuar në raport me një vit më parë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë vazhduar të financojnë shërbimet e përgjithshme publike në rreth 24% të totalit të shpenzimeve dhe ndërkohë që pas këtij funksioni një pjesë të konsiderueshme zëne shpenzimet e Arsimit në rreth 20% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor. Ruajtja e peshës së financimit të funksioneve vendore në 6 mujorët e parë të vitit 2021 dhe 2022 është një tregues i rëndësishëm i qëndrueshmërisë së menaxhimit financiar publik në nivel vendor, duke konsoliduar në këtë mënyrë financimin e shërbimeve vendore.

Grafiku 3 paraqet peshën specifike të shpenzimeve vendore sipas funksioneve në 6 mujorin 2022 kundrejt 2021.



Konsolidimi i financimit të funksioneve të pushtetit vendor dhe menaxhimi i mirë i shpenzimeve është reflektuar gjatë kësaj periudhe në financimin e shërbimeve publike. Rritja e kapaciteteve administrative për mbulimin e shërbimeve publike ka fuqizuar ndjeshëm personelin e njësitë të vetëqeverisjes vendore për të arritur rezultate.



**Statusi Fiskal i Njësive të  
Vetëqeverisjes Vendore  
në fund të muajit Qershor 2021**

Në milion lekë (in million of leks)

Të dhëna progresive


Nr.	EMERTIMI	Qershor 2021	Qershor 2022	Struktura e të ardhurave dhe Shpenzimeve 2022	Ndryshimi 2022/2021	Plani vjetor 2022	% Realizimi ndaj planit
<b>A</b>	<b>TË ARDHURA VENDORE</b>	<b>29,083</b>	<b>32,569</b>		<b>12%</b>	<b>59,250</b>	<b>55%</b>
I	Të ardhura të veta	15,325	18,221	56%	19%	30,472	60%
1.1	Taksa dhe Tarifa të mbldhura në nivel vendor	13,961	16,852	92%	21%	27,632	61%
	a. Taksa e Pasurisë	3,566	3,659	22%	3%	6,187	59%
	b. Biznesi I Vogël	292	40	0%	-86%	0	0%
	c. Taksa dhe tarifa lokale të tjera	10,103	13,153	78%	30%	21,445	61%
1.2	Të ardhura jotatimore	1,359	1,369	8%	1%	2,840	48%
II	Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale	13,500	14,204	44%	5%	28,028	51%
III	Grante të Huaja	258	144	0%	-44%	750	19%
<b>B</b>	<b>SHPENZIMET VENDORE</b>	<b>24,327</b>	<b>24,869</b>		<b>2%</b>	<b>60,290</b>	<b>41%</b>
I	Paga dhe sigurime	11,866	12,181	49%	3%		
II	Operative	6,753	7,395	30%	10%		
III	Subvencione, transfertat dhe Financiare	746	943	4%	26%		
IV	Kapitale	4,962	4,350	17%	-12%		

Të dhënat në tabelën e mësipërme i referohen treguesve fiskalë të konsoliduar për pushtetin vendor të realizuar gjatë 6 mujorit 2022 për të ardhurat sipas burimit dhe shpenzimet sipas natyrës ekonomike.

## Të dhëna për të Ardhurat Vendore


- **Të ardhurat e veta të pushtetit vendor në 6 mujorin e parë të vitit 2022 janë realizuar rreth 16.8 miliard lekë (61% e planit vjetor 2022), ku 78.1% ose 13.1 miliardë e zë grupi i taksave të tjera dhe tarifave vendore. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, të ardhurat e veta vendore janë realizuar me rreth 20.8% më shumë ose në vlerë absolute 2.9 miliard lekë.**

Grafiku 4 paraqet raportin e të ardhurave në taksat dhe tarifave vendore gjatë 6M- 2022/2021.



- Gjatë 6 mujorit të parë 2022 të ardhurat e pushtetit vendor kanë patur një performancë pozitive duke tejkaluar realizimin krahasuar me një në vit me parë si për të ardhurat nga taksat ashtu edhe nga tarifave vendore. **Krahasuar me një vit më parë të ardhurat nga taksat vendore kanë pësuar një rritje rreth 2.5 miliard lekë ose 24% më shumë, trend i njëjtë rritje kanë pësuar edhe të ardhurat nga tarifave vendore me rreth 700 milion lekë.**
- Duke marrë në analizë burimin e të ardhurave vendore në 6 mujorin e parë të vitit 2022 evidentohet **një përmirësim i i performancës së të ardhurave të veta** ku një performancë të ulët rritës paraqitet grupi i **taksave të pasurisë me rritje vetëm 2.6%** ose ndryshe me një realizim në vlerë absolute rreth **93 milion lekë**, ndërkohë një rritje të konsiderueshme ka zëri i taksave të tjera dhe tarifave lokale me rreth 3.1 miliard lekë më shumë ose me një rritje rreth 30% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafiku 5 në vijim paraqet përbërjen e Grupit të Taksave mbi Pasurinë të realizuara në 6M - 2022/2021




- Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022, në përputhje me përcaktimet ligjore ku Taksa e Biznesit të Vogël është parashikuar zero për shkak të ndryshimeve ligjore të cilat e zeruan këtë taksë e cila mbledhej nga pushteti vendor. Pavarësisht këtij ndryshimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë mbledhur gjatë periudhës raportuese **rreth 40 milion lekë** të cilat vinë si rezultat i detyrimeve të papaguara në kohë të këtyre bizneseve.
- Në totalin e taksave dhe tarifave të mbledhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore si burimet më të rëndësishme paraqiten **“Taksa e ndikimit në infrastrukturë”** e cila zë rreth **39.4% ose një masë realizimi rreth 6.6 miliard lekë**, **“Taksa e ndërtesës”** me rreth **16.8% ose ndryshe një masë realizimi 2.8 miliard lekë** dhe **“Tarifa e pastrimit dhe higjienës”** me **17.8% ose ndryshe një realizim rreth 2.9 miliard lekë**.
- **Nga taksat mbi pasurinë** në 6 mujorin e parë të vitit 2021, janë akumuluar gjithsej **3.6 miliard lekë** ose rreth 93 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Peshën më të madhe e ka zëri i **taksës mbi ndërtesën** me një realizim rreth **2.8 miliard lekë ose 80%** të totalit të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë.
- Në raport me totalin e të ardhurave nga taksat e pasurisë, gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022, zëri i **taksës së transaksioneve** të pasurive të paluajtshme të realizuar në masën **389 milion lekë** zë rreth **11% të totalit**, ndërsa zëri i **taksës mbi token bujqesore** është realizuar në vlerën e rreth **279 milion lekë** dhe zë 8% të totalit të taksës së pasurisë. **Zëri i taksës së truallit** realizuar me rreth **159 milion lekë** është edhe zëri që ka peshën më të vogël në taksën e pasurisë **rreth 4%**.
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë**, gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022, me **6.6 miliard lekë zë 39.4%** të vlerës totale të “taksave të tjera lokale” (prej 13.1 miliard lekë). Nga ky burim i të ardhurave vendore krahasuar me të njëjtën

periudhë të një viti më parë, janë akumuluar rreth 2.3 miliard lekë më shumë të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

- **66% e totalit të të ardhurave vendore** (ose 8.6 miliard lekë) është mbledhur nga **Bashkia e Tiranës** gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022. Burimi më i madh i të ardhurave për këtë bashki është “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” e cila arrin vlerën e 5 miliard lekë ose rreth 58% të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat, ose rreth 38% të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë.
- Të grupuara sipas numrit të popullsisë, **bashkitë me mbi 100 mijë banorë** (11 bashki përfshi edhe Tiranën) kanë **realizuar 82% të totalit** të të ardhurave të veta vendore në rang vendi.
- Duke përjashtuar Bashkinë Tiranë, **10 bashkitë me mbi 100 mijë banorë** kanë mbledhur rreth **3.9 miliard lekë ose rreth 21%** të totalit të të ardhurave vendore (për 60 bashkitë e mbetura).
- 13 bashkitë me popullsi **50-100 mijë banorë** kanë mbledhur rreth **1.4 miliard lekë ose 7.8%** të totalit të të ardhurave vendore (të 60 bashkive pa përfshirë Tiranën).
- 37 bashkitë me popullsi **nën 50 mijë banorë** kanë mbledhur **1.8 miliard lekë ose 25%** të totalit të të ardhurave të veta vendore (të 60 bashkive pa përfshire Tiranën).
- Bashkia Tiranë gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022 ka mbledhur rreth **10.9 miliard lekë ose rreth 3.7 miliard lekë më shumë** se të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore të mbledhura sëbashku.


Grafiku 6 prezanton përbërjen e grupit të taksave dhe tarifave të tjera lokale.



## Të dhëna për Shpenzimet Vendore

- **Totali i shpenzimeve të pushtetit vendor** gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022 është rreth **24.8 miliard lekë** ose rreth **41%** të planit vjetor të miratuar prej 60.3 miliard lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet e pushtetit vendor janë realizuar rreth **2.2% më shumë** ose në vlerë absolute rreth **500 milion lekë**.
- Në shpenzimet e realizuara në 6 mujorin e parë të vitit 2022, peshën më të madhe e zënë **shpenzimet e personelit me rreth 49%** e totalit të shpenzimeve vendore, pas tyre vijnë **shpenzimet operative me rreth 29.7%**; **shpenzime të tjera për subvencione dhe transferta me rreth 38%**, ndërsa **shpenzimet për investime zënë rreth 17.5%**.


Grafiku 7 në vijim paraqet strukturën e shpenzimeve vendore sipas natyrës ekonomike në 6 mujorin 2022/2021.



- **Shpenzimet për investime kanë pësuar një rënie të lehtë me rreth 612 milionë lekë ose ndryshe rreth 12.3%** krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- **Bashkia e Tiranës zë rreth 31%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.
- **Shpenzimeve të tjera korrente** (ku përfshihen edhe transfertat familjare, subvencionet) kanë **pasur një rritje** gjatë 6 mujorit të parë 2022 me rreth 198 milionë lekë ose ndryshe me rreth 26.4% krahasuar me një vit më parë.
- Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2022, **peshën më të madhe e zënë shpenzimet e realizuara nga transfertat nga buxheti i shtetit me rreth 57.1%**, ndërsa


ato nga **të ardhurat e veta zënë rreth 42.2%, 0.6% shpenzimet me burim financimin e huaj dhe 0.1% shpenzimet e realizuara me burim financimi të ardhurat jashtë limitit.** Krahasuar me të njëjtën periudhë të një vitit më parë konstatohet një rritje e peshës së shpenzimeve vendore nga transferta e pakushtëzuar me rreth 3% më shumë.

Grafiku 8 prezanton strukturën e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimit të financimit për 6 mujorin 2022/2021.




- **Për Bashkinë Tiranë, 27%** e shpenzimeve janë financuar nga **transfertat** e buxhetit qendror si dhe **73% nga të ardhurat e veta** vendore.
- Në 6 mujorin e parë të vitit 2022, konstatohet rritje të shpenzimeve në funksionet si “Rendi dhe Siguria”, “Mbrojtja e Mjedisit”, “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”, “Shëndetësia”, “Arsimi”, “Argëtimi kultura dhe feja”, dhe “Mbrojtja sociale” në vlerën totale prej **rreth 1.1 miliard lekë** më shumë se një vit më parë.

Grafiku 9: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas funksioneve në 6 mujorin 2021/2020.




- **Funksioni “Mbrojtja e Mjedisit” ka rritjen më të madhe të shpenzimeve** gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, krahasuar me një vit më parë me rreth **670 milion lekë ose 37% më shumë**, dhe më pas vjen “Argëtimi, kultura dhe Feja” me rritje me rreth 26%.
- Krahasuar më të njëjtën periudhë të një viti më parë **funksionet që paraqiten me financim me ulje** janë “Shërbimet e Përgjithshme Publike” me rënie me rreth 5% si dhe “Çështjet Ekonomike” me rreth 6%.
- Bashkia Tiranë, në 6 mujorin e parë të vitit 2022 ka realizuar rreth **29% të totalit** të shpenzimeve të pushtetit vendor **me një vlerë 7.1 miliard lekë**, ndërkohë që shpenzimet për investime të kësaj bashkie **zënë 31%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.
- Të grupuara sipas popullsisë në 6 mujorin e parë të viti 2022, duke përjashtuar Bashkinë Tiranë, **10 bashkitë me mbi 100 mijë banorë** kanë realizuar rreth **7.3 miliard lekë ose 43.7%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor (60 bashki pa Tiranën).
- 13 bashkitë me një popullsi **ndërmjet 50 -100 mijë banorë** kanë realizuar rreth **3.8 miliard lekë shpenzime ose 22.7%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor (60 bashki, pa Tiranën) dhe pjesa tjetër prej 37 bashkive që kanë popullsi **nën 50 mijë banorë** kanë realizuar **rreth 5.6 miliard lekë shpenzime ose ndryshe 33.6%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.

Grafiku 10 paraqet shpenzimet sipas funksioneve vendore dhe burimeve te financimit në 6 mujorin 2022




Grafiku 11 jep krahasimin në pikë përqindje midis gjashtëmujorëve 2022 - 2021 lidhur me shpenzimet sipas funksioneve vendore dhe burimeve të financimit të tyre.






**Paraqitja grafike e treguesve  
në nivel bashkie**


Grafiku 12: Përqindja e të ardhurave si pas bashkive ndaj totalit të ardhurave vendore 6M 2022




Grafiku 13: Peshat e të ardhurave të secilës bashki ndaj totalit të të ardhurave vendore pa bashkinë Tiranë për 6 mujorin 2022




Grafiku 14: Ndryshimi i të ardhurave vendore sipas bashkive në 6 mujorin 2022/2021.




Grafiku 15: Raporti i të ardhurave siaps burimit dhe NJVQV-ve gjatë 6 mujorit 2022



Grafiku 16: Raporti i shpenzimeve sipas llogarive ekonomike dhe NJVQV-ve 6 mujori 2022.



Grafiku 17: Raporti i shpenzimeve sipas burimit dhe NJVQV-ve 6 mujori 2022.



Grafiku 18: Ndryshimi i shpenzimeve vendore sipas bashkive në 6 mujorin 2022/2021.

